

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-063/13

**Prishtinë,
17 shtator 2013**

Në çështjen juridike të

B.B

Paraqitësi i kërkesës / Pala përgjegjëse në ankesë

kundër

H.K

Pala ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, Esmë Erterzi dhe Sylejman Nuredini, anëtarë, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/140/2012 (lënda e regjistruara në AKP me numër KPA50228), e datës 19 shkurt 2012, pas shqyrtimit të mbajtur më 17 shtator 2013, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Hedhet poshtë si e pasafatshme ankesa e H.K kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/140/2012, i datës 29 shkurt 2012 (me kërkesën e regjistruar në AKP më nr. KPA50228).
2. Obligohet pala ankuese H.K që t'i paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej € 30 (tridhjetë) në buxhetin e Kosovës, brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Paraqitësi i kërkesës B.B, si kryefamiljar i familjes së të ndjerit V.B, ka paraqitur më 24 tetor 2007 kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) lidhur me ngastrat numër 25/2, 253/1, 253/2, 253/3 në zonën kadastrale në Shalinovice, komuna e Istogut, me sipërfaqe prej 2 hektarë, 61 ari dhe 49 metra katrorë.

Paraqitësi i kërkesës ka deklaruar se është djali i të ndjerit- pronarit të pronës, dhe se pronën e kishin humbur me 15 qershor 1999 për shkak të rrethanave në vitet 1998/99. Ai pretendon se prona i është uzurpuar nga një person i panjohur dhe ka kërkuar kthimin në posedim të pronës.

Për të mbështetur kërkesën e tij, ai dorëzoi në AKP dokumentet në vijim:

- Fletën poseduese nr. 32 të lëshuar me 8 janar 1992 nga Zyra Kadastrale e Republikës së Serbisë, administrata komunale e gjeodezisë së Istogut, ku evidentohet regjistrimi i pronës së kërkuar në emër të V.B;
- Kopjen e planit kadastral, të datës 8 janar 1992;
- Certifikatën e vdekjes së V.B;
- Certifikatën e lindjes, etj.

Me 14 korrik 2008, AKP-ja vizitoi pronën e pretenduar ku konstatoi llojin e pronës si livadh dhe pemishte pa ndonjë ndërtim mbi to. Ata kuptuan se pronat nuk ishin të uzurpuara nga askush. Raporti i njoftimit u bë në të njëjtën ditë dhe njoftimi u vendos në ato toka. Kërkesa u publikua më 9 shtator 2008. Njoftimi me publikim në gazetë është kryer më 24 shtator 2010.

Më 29 shkurt 2012, KKPK-ja me vendimin e vet KPCC/D/A/140/2012 (me kërkesën e regjistruar në AKP më nr. KPA50228, në plan) ka vendosur se kërkesa është e bazuar, d.m.th. paraqitësit të kërkesës i është vërtetuar pronësia ndaj pronës së pretenduar, të së ndjerit, dhe ka urdhëruar lirimi e pronave nga cilido person.

Vendimi i KPCC/D/A/140/2012 i është dorëzuar palës ankuese, me 19 tetor 2012. Ai refuzoi të nënshkruaj fletëpranimin.

Ai ka paraqitur ankesë me 25 janar 2013, duke thënë se e ka marr paralajmërimin e fundit për largimin e strukturës banues, ku ai pretendon se tokat i janë marr gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ai ka deklaruar se janë kthyer në tokat e tyre pas konfliktit të Kosovës, dhe ku ndërtuan shtëpi për familjen e tij. Ai tutje ka deklaruar se ende është një kontest civil pranë gjykatës kompetente në lëndën nr.C.nr. 112/06. Ai ka kërkuar nga autoritetet gjegjëse lejimin e qëndrimit në shtëpi deri në vendimin përfundimtar të gjykatës për këtë lëndë.

Ankesa i është dorëzuar B.B më 28 mars 2013. Ai ka paraqitur përgjigje në ankesë me datën 12 prill 2013.

Arsyetim ligjor:

Ankesa është e papranueshme.

Neni 10.2 i Rregullorës së UNMIK-ut 2006/50 i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079 përcakton që çdo person tjetër përpos paraqitësit të kërkesës i cili pretendon që ka të drejtë në pronën e kontestuar mund të jetë palë në procedurë nëse ai/ajo ka informuar Sekretariatit Ekzekutiv për qëllimin e saj që të marrë pjesë në procedurë brenda 30 ditësh nga njoftimi i kërkesës. Me qëllim që ky pretendim të ishte në dijeninë e AKP-ës, ky/kjo person duhet të jetë i informuar për procedurën e cila ishte iniciuar. Në lëndën në fjalë, ankuesi nuk kishte paraqitur njoftimin mbi pjesëmarrjen në procedurë pas publikimit të kërkesës në pajtueshmëri me nenin 10.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079. Sidoqoftë, nuk mund të konstatohet se ai ishte njoftuar në mënyrë të drejtë për sa i përket procedurës para AKP-ës, sepse nuk ishte njoftimi fizik, nuk ishte bërë në parcelën e duhur në vitin 2008 i cili ishte bërë vetëm përmes publikimit në gazetën e vitit 2010 në përputhshmëri me praktikën e Gjykatës Supreme mbi interpretimin e njoftimit të drejtë. Prandaj, e drejta e tij nuk është mohuar thjeshtë për shkak të kësaj arsye. Por kjo nuk e bën ankesën e pranueshme sepse ekziston tjetër pengesë procedurale për gjykimin e saj.

Ai e ka kundërshtuar njoftimin e urdhrit për dëbim, të cilin e ka gjetur para derës së tij. Edhe nëse një parashtrësë e tillë konsiderohet si ankesë kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës, ajo është paraqitur pas skadimit të afatit për paraqitjen e ankesave. Ankesa është e jashtëafatshme (Neni 186.2 i Ligjit Nr. 03/L-006 të Procedurës Kontestimore).

Neni 12.1 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, e ndryshuar më Ligjin nr. 03/L-079 parashikon si në vijim: “Brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi ankesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës”.

Gjykata Supreme vëren se pala ankuese H.K nuk ishte madje as palë në procedurë pranë KKPK-së; megjithatë, me 19 tetor 2012 Sekretariati Ekzekutiv kishte tentuar t’i dorëzonte H.K vendimin në lidhje me lëndën KPA50228. Ai kishte refuzuar ta nënshkruaj raportin e pranimit. Formulari i regjistrimit të informatave tregon përpjekjen për dorëzim. Sipas nenit 6.5 (b) të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5, nëse dokumenti është dorëzuar personalisht, ndërsa marrësi ka refuzuar të pranojë dokumentin apo të nënshkruajë dëftesën, ai do të konsiderohet si i dorëzuar në ditën kur është bërë përpjekje për ta dërguar atë. Prandaj, dërgimi i vendimit të KKPK-së tek H.K konsiderohet i kryer më 19 tetor 2012.

Kështu, afati kohor përfundoi më 19 nëntor 2012. Megjithatë, pala e interesuar ka paraqitur ankesën e vet, vetëm më 25 janar 2013, që është jashtë afatit kohor të lartpërmendur. Ai nuk ka dhënë asnjë arsyetim, kështu që gjykata nuk mund të konstatojë asnjë arsye për vonesë. Prandaj, ankesa duhet të hedhet poshtë si e papranueshme për arsye procedurale (neni 13.3 nën-paragrafi (b) i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079).

Shpenzimet e procedurës:

Në përputhje me Shtojcën III, nenit 8.4 të Urdhërësës Administrative (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë, një përjashtim i tillë nuk është i paraparë për procedurat para Kolegjit të Apelit. Si pasojë, regjimi normal i pagesës së taksave gjyqësore të paraparë më Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, 3 tetor 1987) dhe me UA Nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi unifikimin e taksave gjyqësore janë të vlefshme për procedurat para Kolegjit të Apelit.

Kështu që, taksat e mëposhtme të gjykatës zbatohen për procedurat aktuale të apelit:

- Taksa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UA 2008/2): 30 €

Këto shpenzime duhet të barten nga pala ankuese e cila humbi rastin.

Këto taksa gjyqësore duhet të merren përsipër nga pala ankuese e cila humb rastin.

Sipas nenit 45.1 të Ligjit mbi Taksat Gjyqësore, afati për pagesën e saj është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë. Në rast se pala nuk paguan taksën brenda afatit, do të urdhërohet ekzekutimi i detyrueshëm përfshirë gjobën siç parashihet me nenin 47 e të njëjtit ligj.

Udhëzim juridik

Sipas Nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50, i ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet me mjete të rregullta dhe ato jashtëzakonshme juridike.

Elka Filcheva-Ermenkova, *Kryetare e Kolegjit, EULEX*

Esma Erterzi, Gjyqtare e EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nufer, Referent i EULEX- it